



NIS FORMIMI I INSTITUCIONEVE TË DALA NGA ZGJEDHJET E 28 DHJETORIT

FAQE 4-5

Sot (e mërkurë) në orën 12:00 presidentja e vendit, Vjosa Osmani, ka thirrur mbajtjen e seancës konstituive të Kuvendit të Kosovës. Ajo ka njoftuar se ky vendim ka ardhur pas konsultimit me shumicën e partive parlamentare të përfaqësuara në Kuvend dhe duke pasur parasysh urgjencën e krijimit të institucioneve, miratimit të buxhetit dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi



PROKURORIA DHE MBROJTËSI I VIKTIMAVE PËRFUNDOJNË DEKLARATAT PËRMBYLLËSE, RADHËN E KA MBROJTJA E LIDERËVE TË UÇK-së

FJALA PËR MBROJTJEN E LIDERËVE TË UÇK-së

F. 8

SHËRBI MI SEKRET I SERBISË DHE PROKURORIA POLITIKE NË HAGË

F. 8

SHKRUAN: BARDHYL MAHMUTI



AKTUALE



BE-JA PO BËN PËRGATITJE PËR NDALIMIN E MEDIEVE SOCIALE PËR FËMIJËT F. 2

SPECIALJA LIRON HAXHI SHALËN, BASHKIM SMAKAJN DHE FADIL FAZLIUN F. 7

SHBA-ja DO TË VAZHDOJË TA MBËSHITESË FSK-në ME PAJISJE USHTARAKE F. 6

EKONOMI



ISMAILI MIRËPRET MISIONIN E ASISTENCËS TEKNIKE TË FMN-së PËR FORCIMIN E MODELIMIT DHE PARASHIKIMIT MAKROEKONOMIK F. 8

SINDIKATA E PUNËTORËVE PRIVATË: SHUMË KOMPANI NUK PO E RESPEKTOJNË RITJEN E PAGËS MINIMALE PREJ 425 EUROSH F. 8

SPORT



MBAHET PUNËTORIA PËR PROCESIN E LICENCIMIT TË KLUBEVE PËR GARAT EVROPIANE PËR EDICIONIN 2026-2027 F. 11

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

BE-ja PO BËN PËRGGATITJE PËR NDALIMIN E MEDIEVE SOCIALE PËR FËMIJËT

BRUKSEL, 10 SHKURT - Ekspertët kanë rezerva se si do të zbatohet një ndalim i tillë dhe nëse ai do të funksionojë: Ligji i BE-së për shërbimet digjitale nuk është i përshtatshëm për nxitjen e ndryshimeve sistematike në platformat digjitale.

Disa ditë pasi ligjvënësit francezë votuan për ndalimin e rrjeteve sociale për fëmijët nën moshën 15 vjeç, kryeministri spanjoll Pedro Sanchez premtoi t'i mbrojë fëmijët e Spanjës "nga Perëndimi i Egër digjital".

Orët e shfletimit (scroll) të përmbajtjes së dëmshme po riformatojnë trurin e të rinjve dhe shkaktojnë ankth e rreziqe të tjera për shëndetin, thonë ekspertët, duke detyruar qeveritë evropiane të veprojnë. "Fokusi i veçantë mbi të miturit vjen për shkak të rrezikut të shtuar të dëmeve afatgjata, pasi ata ende po zhvillohen kognitivisht", i tha DW Paul O. Richter, bashkëpunëtor i lidhur me think tank-un Bruegel me bazë në Bruksel. "Ekziston shumë hulumtim që tregon korrelacione të forta midis përdorimit të mediave sociale dhe problemeve të shëndetit mendor".

Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, gjithashtu ka shprehur mbështetje për një kufi moshe në të gjithë BE-në, në përputhje me një ligj të ri australian që vendosi kufirin e moshës 16 vjeç për përdorimin e rrjeteve sociale.

Por si mund të zbatohet një ndalim i tillë dhe a do të funksiononte vallë?

Cilat vende evropiane po mendojnë t'i ndalojnë rrjetet sociale për fëmijët?

Në Francë, projektligji që kërkon ndalimin për të miturit nën moshën 15 vjeç do të dërgohet tani në senatin e parlamentit francez për votim. Në Spanjë pritet që Këshilli i Ministrave ta miratojë ndalimin për të miturit nën moshën 16 vjeç dhe ta shtojë klauzolën në një projektligj që është në diskutim në parlamentin spanjoll. "Sot fëmijët tanë janë të ekspozuar ndaj një hapësire që kurrë nuk ishte menduar ta

lundronin vetëm, një hapësirë varësie, abuzimi, pornografisë, manipulimit dhe dhunës", tha Sanchez ndërsa njoftoi ndalimin e propozuar.

Edhe vende të tjera evropiane po konsiderojnë një ndalim të rrjeteve sociale për fëmijët nën moshën 16 ose 15 vjeç.

Në fund të vitit 2025, Danimarka vendosi t'i mbrojë fëmijët dhe të rinjtë nga keqtrajtimi online dhe "të krijojë një kuadër më të mirë ligjor për jetën e tyre digjitale".

Në një marrëveshje shumëpartiake, grupet politike në Danimarkë thanë se qasja në disa platforma të medievet sociale duhet të ndalohej. Një ligj ende nuk ka hyrë në fuqi.

Italia ka paraqitur gjithashtu një projektligj në parlamentin italian për të vendosur kufizime në mediet sociale, përfshirë edhe për influencuesit fëmijë nën moshën 15 vjeç.

Sipas një zyrtari të lartë që foli për agjencinë e lajmeve "Reuters", Greqia është "shumë pranë" vendosjes së një ndalimi të ngjashëm.

Javën e kaluar Portugalia paraqiti një projektligj që kërkon pëlqimin e prindërve për fëmijët nën moshën 16 vjeç për të aksesuar përmbajtjen e rrjeteve sociale.

Austria, gjithashtu, po shqyrton një ndalim të rrjeteve sociale, ndërsa Mbretëria e Bashkuar ka nisur një proces konsultimi mbi këtë çështje.

Ndërkohë, parlamentarët evropianë nëntorin e kaluar (2025) rekomanduan një ndalim të medievet sociale në të gjithë Evropën për fëmijët nën moshën 16 vjeç, ndërsa sugjeruan që adoleshentët 13 deri në 16 vjeç të mund të kenë qasje me pëlqimin e prindërve.

Një ID digjitale në të gjithë BE-në për ta verifikuar moshën?

Një ide që po diskutohet për verifikimin e moshës është një ID digjitale në të gjithë BE-në. Richter, bashkëpunëtor i lidhur me Bruegel, tha se ID-ja digjitale e BE-së parashikohet si një mjet që do ta verifikonte moshën e përdoruesit pa kompromentuar të dhënat personale. "Do t'u lejonte njerëzve të verifikonin në



mënyrë digjitale se janë mbi një moshë të caktuar pa pasur nevojë për të regjistruar asnjë të dhënë personale shtesë, si data e lindjes, emri, adresa ose numri i identifikimit. Kjo do të lehtësonte zbatimin e një kufizimi moshor digjital", tha Richter.

Por Marc Damie, zëdhënës i ctrl+alt+reclaim të Francës - një lëvizjeje e drejtësisë teknologjike dhe të drejtave digjitale e drejtuar nga të rinjtë - pretendoi se detajet rreth mënyrës se si do të funksiononin aplikacionet ose dokumentet e identifikimit për verifikimin e moshës, dhe nëse informacioni privat do të ishte i sigurt, janë të paqarta. "Të tilla ndalime do të kenë efekt të kundërt", tha ai. "Ne pajtohemi që ekziston një problem, mediat sociale po shkaktojnë çështje të shëndetit mendor, por një ndalim i tillë", pretendoi ai, "është thjesht një masë simbolike nga ana e politikanëve dhe jo një zgjidhje e vërtetë".

Eksperti: Ndalimi i medievet sociale nuk do t'i lehtësonte 'problemet strukturore'

"Ndalimi nuk i zgjidh problemet strukturore" në platformat e medievet sociale, tha Damie. Ai theksoi si çështje kryesore praktikën e platformës si autoplay - e cila u imponon përdoruesve përmbajtje audio dhe video të padëshiruara dhe të papritura - dhe skrolimin e pafund që shkakton ankth, i

destinuar për t'i mbajtur përdoruesit të lidhur online. Damie gjithashtu kundërshtoi kufirin e moshës, sepse "varësia nuk ndalet në 15 ose 16 vjeç". Richter u pajtua se mungesa e kërkimeve të mjaftueshme e bën të vështirë të argumentohet në mënyrë përfundimtare për një moshë specifike si kufiri optimal. "Disa nga rreziqet e mundshme lidhen specifikisht me efektin që ka krahassimi social nga mediat sociale te vajzat adoleshente dhe të reja", tha ai. "Prandaj, një kufi moshe më i lartë mund të justifikohet".

Vetëm BE-ja mund t'i detyrojë platformat online të bëjnë ndryshime sistematike

Bashkimi Evropian ka mbështetur një moshë madhore digjitale, por ka paralajmëruar shtetet anëtare që të mos shkelin Ligjin e tij për Shërbimet Digjitale (DSA), i cili kërkon nga kompanitë teknologjike të zbusin rrezikun lidhur me algoritmet dhe ndikimin te të miturit. "DSA dhe Komisioni i BE-së janë entitetet e vetme që mund të vendosin detyrime shtesë mbi platformat shumë të mëdha", u tha gazetarëve Thomas Regnier, zëdhënësi i Komisionerit për Teknologjinë. Richter tha, se shtetet anëtare janë thjesht të zhgënjyera dhe nuk mendojnë se BE-ja është në gjendje t'ua imponojë në mënyrë efektive ligjet e saj kompanive të huaja të

teknologjisë, kryesisht atyre në ShBA. "Ligji DSA kërkon nga platformat e mëdha online si rrjetet sociale të njohura që... të ndryshojnë algoritmet dhe dizajnin e platformës për të zbutur rreziqet sistematike, përfshirë ato për të miturit", tha Richter. "Ligji i BE-së gjithashtu kërkon që ata të ndajnë të dhëna me studiuesit për të lejuar kërkime të pavarura mbi rreziqet. "Në praktikë, kjo nuk ka ndodhur në mënyrë sinjifikative. Prandaj propozimet për rregullore më të rrepta, duke përfshirë ndalimet e medievet sociale, kanë fituar më shumë mbështetje", shtoi ai.

Para një jave, Elon Musk, pronari i platformës së medievet sociale X, e etiketoi kryeministrin e Spanjës "një tiran dhe tradhtar të popullit të Spanjës", pasi ky i fundit njoftoi planet e tij për të ndaluar mediat sociale për fëmijët. Musk është përpjekur t'i paraqesë rregulloret evropiane për krijimin e hapësirave të sigurta online si një mashtrim për të penguar lirinë e shprehjes online.

Damie tha, se ka ardhur koha që vendet e BE-së "të investojnë së bashku në alternativa evropiane" për platformat sociale jo-evropiane. "Ne jemi peng i kompanive të mëdha amerikane", tha ai. Realiteti është "ose me ato ose s'ka jetë digjitale", tha ai. Kjo ide po diskutohet mes ekspertëve me shpresën se një platformë evropiane do t'i përmbushte më mirë rregulloret dhe vlerat e BE-së.

NIS FORMIMI I INSTITUCIONEVE TË DALA NGA ZGJEDHJET E 28 DHJETORIT

Sot (e mërkurë) në orën 12:00 presidentja e vendit, Vjosa Osmani, ka thirrur mbajtjen e seancës konstituive të Kuvendit të Kosovës. Ajo ka njoftuar se ky vendim ka ardhur pas konsultimit me shumicën e partive parlamentare të përfaqësuar në Kuvend dhe duke pasur parasysh urgjencën e krijimit të institucioneve, miratimit të buxhetit dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 10 SHKURT - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thirrur për të mërkurën, më 11 shkurt, seancën për konstituim të Kuvendit të Kosovës. “Pas konsultimit me shumicën e partive parlamentare të përfaqësuar në Kuvend dhe duke pasur parasysh urgjencën e krijimit të institucioneve, miratimit të buxhetit dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, presidentja ka vendosur që seancën konstituive të Kuvendit ta ftojë për nesër, më 11 shkurt 2026, në orën 12:00”, është thënë në njoftimin e Presidencës. Pas vendimit të Osmanit për seancën konstituive, nënkryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Glauk Konjufca, shprehu bindje se nesër do të konstituohet organi ligjvënës dhe do të formohet Qeveria e re e Kosovës. “Nesër do të bëhet Kuvendi dhe nesër shumë shpresoj që do të bëhet edhe qeveria. Për të tjerat flasim pastaj”, tha Konjufca për medie.

I pyetur për çështjen e nënkryetarit serb që, sipas Gjykatës Kushtetuese, duhet të propozohet nga shumica e deputetëve të komunitetit serb, në këtë rast nga Lista Serbe që ka nëntë deputetë, Konjufca tha se partia e tij asnjëherë nuk ka refuzuar aktgjykimet e gjykatës më të lartë në Kosovë. “Ne kurrë nuk i kemi refuzuar aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese. Deri tash vazhdimisht Lëvizja Vetëvendosje, ato natyrisht kanë qenë beteja politike, por kur i ka dhënë vulë Gjykata Kushtetuese siç ishte rasti për shembull në vitin 2014 kur tha që jo, ju nuk mundeni me bë



shumicën, shumicën duhet ta bëjë vetëm fituesi i zgjedhjeve, ne u tërhoqëm dhe vazhduam sipas opinionit të Gjykatës”, u shpreh ai.

LV-ja legjislaturën e kaluar kishte votuar kundër të propozuarve për nënkryetarë nga Lista Serbe - partia kryesore e serbëve në Kosovë që ka mbështetjen e Beogradit - dhe nënkryetar më pas u zgjodh Nenad Rashiq nga Partia për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë.

Vendimi i presidentes për seancën konstituive vjen një ditë pasi Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) në Kosovë e ka certifikuar rezultatin e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 28 dhjetorit. Sipas të dhënave të KQZ-së, Lëvizja Vetëvendosje ka fituar 51.10 për qind të votave, duke siguruar 57 ulëse në Kuvendin e Kosovës. Partia Demokratike e Kosovës ka marrë 20.19 për qind të votave, apo 22 ulëse, Lidhja Demokratike e Kosovës 13.24 për qind, apo 15 ulëse, ndërsa Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës 5.50 për qind, apo gjashtë ulëse.

Nga ulëset e rezervuara për minoritetin serb, nëntë ulëse i ka fituar Lista Serbe, partia më e madhe e serbëve në Kosovë, dhe një ulëse Partia për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë. Procesi i certifikimit u zvarrit

për shkak të nevojës për rinumërim të të gjitha votave të këtij procesi zgjedhor, meqë pati dyshime për manipulime të votave të kandidatëve për deputetë.

Dhjetëra persona janë dërguar në paraburgim, qindra të tjerë janë intervistuar nën dyshimet për manipulim të votave, dhe proceset hetimore e gjyqësore pritet të vazhdojnë. Votat për parti nuk janë cenuar.

Çfarë ndodh në seancën konstituive?

Rregullorja përcakton se duhet të ketë përgatitje për seancën konstituive dhe kjo përgjegjësi bie mbi kryetarin e legjislaturës paraprake, në këtë rast është në përgjegjësinë e Dimal Bashës. Ai duhet që jo më vonë se pesë ditë para mbajtjes së seancës konstituive të zhvillojë një takim të përbashkët me krerët e subjekteve politike parlamentare, për të përgatitur rendin e ditës dhe për të caktuar vendet e deputetëve në Kuvendin e ri.

Rregullorja përcakton se seanca konstituive ka katër pika të rendit të ditës: formimin e Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve, betimin e deputetëve, zgjedhjen e kryetarit të Kuvendit dhe atë të nënkryetarëve.

Lidhur me seancën konstituive, vitin e kaluar pati shumë paqartësi dhe Gjykata Kushtetuese përmes disa aktgjykimeve përcaktoi se kjo seancë duhet të përmbyllet brenda 30 ditësh, dhe konsiderohet e përmbyllur vetëm me zgjedhjen e kryetarit dhe pesë nënkryetarëve - tre nga partitë kryesore shqiptare dhe dy nga komunitetet joshumicë, një serb dhe një nga komunitetet serbe.

Si për kryetarin, ashtu edhe për nënkryetarët kërkohen 61 vota nga Kuvendi me 120 deputetë. Në bazë të aktgjykimeve, një person mund të propozohet vetëm deri në tri herë për postin e kryetarit dhe nënkryetarëve. Megjithatë, për çështjen e nënkryetarit serb, në një aktgjykim të publikuar ditë më parë, Kushtetuesja gjeti se janë bërë shkelje kur është zgjedhur Nenad Rashiq nga Partia për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë, përmes shortit në legjislaturën e kaluar. Ai u propozua në këtë mënyrë pasi të propozuarit e Listës Serbe s'arritën t'i siguronin 61 vota.

Kushtetuesja vendosi se të drejtën e propozimit për nënkryetar e kanë shumica e deputetëve të komunitetit serb, që edhe në këtë legjislaturë janë nëntë deputetët e Listës Serbe. Vendimi u kritikua nga Lëvizja Vetëvendosje e Albin Kurtit dhe mbetet e paqartë se si do të veprojnë ata për çështjen e nënkryetarit serb gjatë legjislaturës së re.

Me t'u përmbyllur çështja e konstituimit, hapet rruga për formimin e Qeverisë së re të Kosovës. Presidentja duhet të mandatojë për kryeministër dikë nga partia fituese, në këtë rast LVV-ja.

I mandatuari, më pas, i ka 15 ditë kohë që të paraqesë para Kuvendit përbërjen e re të ekzekutivit dhe të kërkojë mbështetjen e të paktën 61

deputetëve.

Për dallim nga hera e kaluar, Kurti pritet të mos ketë vështirësi për t'i bërë numrat për qeverinë, pasi vetëm partia e tij ka fituar 57 ulëse në Kuvend.

Çështja e presidentit

Nëse deputetët duan që të mos shkohet sërish në zgjedhje, atëherë ata do të duhet të veprojnë shpejt për konstituimin e Kuvendit dhe formimin e qeverisë, që të arrihet afati i 4 marsit – data e fundit për zgjedhjen e presidentit të ri të vendit. Presidentja Osmani ka mandat deri më 4 prill, por presidenti i ri nuk mund të zgjidhet më vonë se 30 ditë para kësaj date.

Vetë Osmani ka shprehur dëshirë që të jetë në krye të shtetit edhe për një mandat pesëvjeçar. Megjithatë, mbetet e paqartë nëse ajo do të arrijë të sigurojë mbështetjen e nevojshme.

Kreu i LV-së, Albin Kurti, ka thënë për mediet ditë më parë se ka biseduar me Osmanin për çështjen e presidentit por që, sipas tij, duhet të ekzistojë një raport i ri me partitë në opozitë për çështjen e kreut të ri të shtetit.

Në bazë të Kushtetutës, presidenti i ri zgjidhet përmes votimit të fshehtë dhe kushdo që dëshiron të garojë duhet t'i mbledhë nënshkrimet e të paktën 30 deputetëve.

Kreu i shtetit zgjidhet me dy të tretat e votave në dy raundet e para të votimit, por nëse në këto dy votime s'ka numra të mjaftueshëm, atëherë në raundin e tretë zgjidhet ai kandidat që merr shumicën e votave të deputetëve.

Në rast se dështon zgjedhja e presidentit, me automatizëm shpallen zgjedhjet e reja, që duhet të mbahen brenda 45 ditësh.

Rritet numri i qytetarëve që kanë raportuar rastet e të shtënave me armë

PRISHTINË, 10 SHKURT - Në Ministrinë e Punëve të Brendshme u mbajt takimi i Grupit Punues për Implementimin e Strategjisë dhe Udhërrëfyesit Rajonal për Armë të Vogla, të Lehta dhe Eksplozivë, i cili u hap nga zëvendësministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme, njëherësh Koordinator Nacional për zbatimin e Strategjisë së AVLE-ve, Blerim Gashani. Takimi kishte për qëllim

vlerësimin e zbatimit të Strategjisë, ku u diskutua për realizimin e objektivave strategjike dhe aktivitetëve të planifikuar.

Gjatë këtij takimi u vlerësua një numër i konsiderueshëm i aktivitetëve janë realizuar në përputhje me masat e përcaktuara, ndërsa u diskutua edhe për format e adresimit të aktivitetëve që ende nuk janë realizuar në kuadër të kësaj strategjie.

Një vëmendje e veçantë iu kushtua fushatës vetëdijesuese, për të cilën u theksua se ka dhënë rezultate shumë efektive, duke shënuar rritje të numrit të qytetarëve që kanë raportuar rastet e të shtënave me armë.

Po ashtu, u diskutuan sfidat e mbetura dhe nevoja për përmirësim të mëtejme të zbatimit të aktivitetëve, me qëllim avancimin e Planit të Veprimit dhe arritjen e objektivave strategjike të Strategjisë për AVLE.





PROKURORIA DHE MBROJTËSI I VIKTIMAVE PËRFUNDOJNË DEKLARATAT PËRMBYLLËSE,
RADHËN E KA MBROJTJA E LIDERËVE TË UÇK-SË

FJALA PËR MBROJTJEN E LIDERËVE TË UÇK-së

Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) dhe mbrojtësi i viktimave kanë përfunduar deklaratat përmbyllëse në procesin gjyqësor ndaj liderëve të UÇK-së. Për dy ditë ZPS-ja ka tentuar ta “argumentojë” kërkesën për dënimin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Këtë kërkesë të ZPS-së nga sot (e mërkurë) do të nisë ta çmontojë mbrojtja e katërshe të UÇK-së. Pas mbrojtjes, të drejtën e deklaratës përmbyllëse do ta kenë edhe Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi

kanë humbur pjesëtarët e familjes, kanë menduar se nuk do të kenë drejtësi, por shteti i së drejtës nënkupton që askush nuk është mbi ligjin. Edhe njerëzit më të fuqishme do të japin llogari. Ne kërkojmë bazuar në prova, të cilat vërtetojnë. Kërkojmë të jepet dënimi i duhur. Faleminderit për mundësinë!”, ka thënë ajo në fund fjalës së saj.

Pas deklaratës përfundimtare të kryeprokurores West, deklaratat e tyre përmbyllëse i kanë paraqitur edhe disa nga prokurorët. Ata kanë folur për rolin dhe përgjegjësinë e katër liderëve të UÇK-së, duke përfshirë edhe raportet me ndërkombëtarët. Prokurori Matt Halling ka dhënë një deklaratë qesharake. Ai ka thënë se ajo që nuk kuptonin ndërkombëtarët, duke përfshirë edhe James Rubin dhe Wesley Clark, ishte që Hashim Thaçi ishte i aftë të maskonte atë që po ndodhte në realitet. Ai ka thënë se kjo ka ndikuar në botëkuptimin e ndërkombëtarëve për të kuptuar se si funksiononte në të vërtetë UÇK-ja. “Ajo që nuk kupton James Rubin, Wesley Clark dhe ndërkombëtarët e tjerë, është që Thaçi ishte i aftë të maskonte atë që po ndodhte në realitet dhe kjo ndikoi në botëkuptimin e tyre për të

kuptuar se si funksiononte në të vërtetë UÇK-ja”, ka thënë ai. Përveç kësaj, Matt Halling, ka thënë se këta dy ndërkombëtarë, nuk kishin kurrfarë interesi që të kuptojë se çfarë po ndodhte në realitet. “Veçanërisht Rubin dhe Clark nuk kishin kurrfarë interesi që të kuptonin se çfarë po ndodhte në realitet dhe besonin se puna e tyre.. ishin në anën e duhur të historisë dhe nuk u përballën me atë se çfarë po dëgjon ky trup gjykues për të cilin do t’i marrin vendimet përkatëse”, ka thënë Halling.

Kujtojmë se të hënën kryeprokuroria e specializuar e Speciales, Kimberly West, ka kërkuar të merret vendim për dënim me burgim ndaj secilit prej të akuzuarve. “Të akuzuarit kanë kryer krime ndaj kundërshtarëve të tyre të perceptuar për të pasur kontroll në gjithë Kosovën... Dëshmitë e të gjithë dëshmitarëve si dhe të gjitha provat tregojnë se të gjitha këto krime janë kryer dhe se të akuzuarit mbajnë përgjegjësi ligjore për to”, ka thënë West, duke kërkuar nga trupi gjykues t’i dënojë me nga 45 vjet burgim Thaçin, Veselin, Selimin dhe Krasniqin. “Ne i qëndrojmë faktit që ne kërkojmë dënimin e personave

konkretë. Nuk kërkojmë një dënim për shtabin e përgjithshëm, po për persona konkretë. Zyra e Prokurorisë Speciale (ZPS) kërkon vendim dënimi për të gjitha pikat e aktakuzës dhe vendosjen e një vendimi të vetëm prej 45 viteve, mbështetur në kontributet individuale të krimeve të bëra ose të kryera nga secili prej personave - Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi. Këto krime janë krime lufte dhe krime kundër njerëzimit dhe janë të rënda në natyrë”, ka thënë prokurorja West.

**Mbrojtësi i viktimave:
Duam që zëri i viktimave
të dëgjohet**

Pa përmbylljes së deklaratës përfundimtare të ZPS-së, radha i ka ardhur mbrojtësit të viktimave, Simon Laws. Ai gjatë paraqitjes së deklaratës përfundimtare, ka thënë se dëshiron që në vendimin e trupit gjykues për katërshen e UÇK-së të dëgjohet zëri i viktimave. “Kjo aktakuzë nuk është përshkrim i thatë ligjor i akteve kriminale, por bëhet fjalë për vende, kohë kur njerëzit kanë pësuar dëme të mëdha, që kanë ndryshuar ata

**EPOKA
ERE****Lirim GECI**

HAGË, 10 SHKURT - Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) në Gjykatën Speciale në Hagë ka përfunduar deklaratën përmbyllëse në procesin gjyqësor ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

Në ditën e dytë dhe të fundit të paraqitjes së deklaratës përfundimtare, kryeprokuroria e ZPS-së, Kimberly West, ka treguar se në këtë proces gjyqësor kanë qenë të përfshirë mbi 130 dëshmitarë. “Mbi 5 mijë prova janë pranuar. 28 mijë faqe transkriptime janë këtu. Procesverbalet është voluminoz. Aty paraqitet dëshmia e më shumë se 130 dëshmitarëve që dhanë dëshmi brenda 227 ditëve të

gjykimit. Gjykata ka marrë parasysh edhe dokumentet shkresore, të më shumë se 130 dëshmitarëve. Ka qenë privilegj për mua dhe zyrën që përfaqësoj të takoj shumë prej këtyre njerëzve që kanë përjetuar këto ngjarje”, ka thënë West, duke kërkuar nga trupi gjykues t’i dënojë liderët e UÇK-së. “Njerëz që kanë jetuar për më shumë se 20 vjet me pasojat e krimeve që kanë pësuar në mënyrë të pakuptueshme, edhe viktimat e krimeve për të cilat janë ngritur aktakuza. Zyra ime ka punuar që atyre t’u jepet llogari. Këto përpjekje e procedim penal janë pjesë e parimit më të shenjtë të drejtësisë, shtetit ligjor. Shteti i së drejtës, në kohën e luftës, është më i rëndësishëm. Kanë kaluar shumë vite dhe ata që



dhe familjet e tyre. Duke pranuar që ka ndodhur ky dëm, një trup gjykues është në gjendje të thotë se vuajtja e viktimave nuk është anashkaluar. Ajo që presim që të ndodhë është që viktimat të kenë zërin e tyre dhe që zëri i tyre të jetë dëgjuar”, ka thënë Laws. Sipas tij, të gjitha viktimat kanë pyetur veten “pse më ndodhi kjo mua”, duke ngritur pyetje të tjera pse njerëzit duhej të ndaloheshin e më pas të keqtrajtoheshin. “Pse duhej të përfundonin në varre të pashënuara?”, ka thënë ai, duke përmendur disa ngjarje që kanë ndodhur gjatë luftës.

Sot mbrojtja e liderëve të UÇK-së nisin paraqitjen e deklaratave përmbyllëse

Për sot (e mërkurë) është rezervuar për deklaratat përmbyllëse të mbrojtjes së Thaçit dhe asaj të Veselit, ku kjo e fundit do të vazhdojë edhe të enjten për të pasuar më pas me Krasniqin. Mbrojtja e Krasniqit do ta përfundojë deklaratën e saj përmbyllëse të premten dhe pastaj do të vazhdojë ajo e Selimit. Aktakuza kinse për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit ndaj katërshes së UÇK-së është konfirmuar më 26 tetor të vitit 2020. Më 9 nëntor të vitit 2020, në paraqitjet e tyre të para, Jakup Krasniqi dhe Hashim Thaçi janë deklaruar të pafajshëm për akuzat që u vihen në barrë. Njëjtë është deklaruar edhe Veseli në paraqitjen e tij më 10 nëntor, sikurse edhe Rexhep Selimi më 11 nëntor. Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi ndodhën në paraburgim që nga nëntori i vitit 2020, ndërsa procesi gjyqësor ndaj tyre ka nisur në prill të vitit 2023.

Edi Rama e quan idiot ndërkombëtar prokurorin e Speciales

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka reaguar pas kërkesës së Prokurorisë në Hagë për dënimin me nga 45 vjet burg të krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Në një postim në rrjetin social “X”, Rama ka shprehur tronditjen e tij dhe ka shkruar se ende po mundohet të kuptojë logjikën që ka

ndjekur prokuroria për këtë vendim. “Nuk po shprehem dot, pasi ende po mundohem ta gjej ku buron filli logjik që ka ndjekur prokuroria për të dalë me kërkesën për varrosje për së gjalli të katër burrave dhe si kurrë ndonjëherë, fjalët nuk më vijnë në ndihmë për t’u shprehur... Ndjesë, më duhet kohë ta gëlltis gjithë atë mal me mut që nxori sot ajo prokurori në zemër të Evropës demokratike!”, ka shkruar Rama.

Po ashtu, Rama e ka quajtur “idiot ndërkombëtar”, një prej prokurorëve të Hagës, i cili përgjatë deklaratës përmbyllëse të organit të akuzës, ka thënë se

Hashim Thaçi ua kishte maskuar realitetin James Rubinit dhe Wesley Clarkut. “Çfarë idioti ndërkombëtar”, ka shkruar Rama në “Facebook”, duke e shpërndarë videon e prokurorit Halling.

Krahas Ramës, lidhur me kërkesën e ZPS-së për dënimin e liderëve të UÇK-së, kanë reaguar edhe lideri i opozitës shqiptare, Sali Berisha, kryediplomatja Elisa Spiropali, ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, shefi i deputetëve të PS-së, Taulant Balla etj.

Berisha ka thënë se aktakuza kundër krerëve të UÇK-së është “ripërsëritje e shpifjeve të propagandës të


ultranacionalistëve serbë”.

Kujtojmë se kundër kërkesës së ZPS-së kanë reaguar edhe presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, kryeministri në detyrë, Albin Kurti, kryetari i PDK-së, Bedri Hamza, përfaqësues nga shoqëria civile etj.

OVLUÇK-ja: Akuzat për “ndërmarrje kriminale”, tentativë për rishkrim të historisë

Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK (OVLUÇK) ka shprehur shqetësim të thellë dhe kundërshtim të fuqishëm ndaj përmbytjes dhe gjuhës së përdorur në fjalët përmbyllëse të Prokurorisë në Dhomat e Specializuara në Hagë. “Pretendimet e paraqitura, përfshirë etiketimin e udhëheqjes së UÇK-së si pjesë e një ‘Ndërmarrjeje të Përbashkët Kriminale’, përbëjnë një tentativë të papranueshme për kriminalizimin e luftës sonë çlirimtare dhe për rishkrimin e historisë së rezistencës së drejtë të popullit të Kosovës. UÇK-ja ishte dhe mbetet ushtri çlirimtare, e lindur nga nevoja për mbijetesë dhe liri, e mbështetur nga populli dhe e njohur nga bashkësia ndërkombëtare si palë legjitime në luftën kundër regjimit gjenocidal serb”, është thënë në reagimin e OVLUÇK-së.

Kjo organizatë ka riafirmuar bindjen se kjo gjykatë po zhvillon një proces selektiv dhe të njëanshëm, duke injoruar krimet shtetërore të Serbisë dhe duke u fokusuar padrejtësisht mbi drejtuesit e luftës çlirimtare. “Ne do të vazhdojmë të mbrojmë të vërtetën historike, dinjitetin e luftës sonë dhe figurën e bashkëluftëtarëve tanë. ‘Drejtësia e vërtetë nuk ndërtohet mbi shtrembërim faktesh, por mbi të vërtetën e plotë’, është thënë në këtë reagim.



SHËRBIMI SEKRET I SERBISË DHE PROKURORIA POLITIKE NË HAGË



Shkruan: Bardhyl
MAHMUTI

Që të kuptohet ndërlidhja e Shërbimit Sekret të Serbisë me prokurorët e procesit politik që po zhvillohet në Hagë, më duhet të sqaroj lexuesin për rolin e Milovan Drecunit dhe të Grupit Punues të Serbisë në orientimin e prokurorëve të angazhuar në Zyrën e Prokurorit të Specializuar. Që të kuptohet në tërësi ky rol, paraprakisht më duhet ta njoftoj lexuesin shkurtimisht për disa fakte që kanë të bëjnë me Milovan Drecunin. që jo rrallë edhe në mediat tona cilësohet si “kryetar i Komisionit Parlamentar të Serbisë për Kosovën”. Më 1 korrik 2009, në Gjykatën për Krime Luftë në Serbi, Shoqata e Gazetarëve të Pavarur të Serbisë dorëzoi padinë kundër gazetarëve të Radio-Televizionit të Beogradit, të Radio-Televizionit të Novi Sadit, si dhe kundër gazetarëve të gazetave Politika, Večernje Novosti dhe të gjithë atyre, që gjatë shpërbërjes së Federatës Jugosllave u vunë në shërbim të propagandës luftënxitëse. Nëpërmjet kësaj padie, Shoqata e Gazetarëve të Pavarur të Serbisë akuzoi gazetarët që i kishin shërbyer kësaj propagande, se kanë

manipuluar me mediat, me qëllim të përhapjes së urrejtjes ndërnacionale dhe ndërfetare, të nxitjes së diskriminimit dhe të armiqësive, me çka kanë krijuar parakushtet psikologjike për dhunën dhe për krimet më brutale. Për këtë arsye, kjo shoqatë kërkoi nga Gjykata për Krime Luftë në Serbi, që në përputhje me nenin 145 të Kodit Penal të Republikës Federative të Jugosllavisë të dënoshin këta gazetarë për veprën penale të organizimit dhe të nxitjes së kryerjes së gjenocidit dhe të krimeve të luftës. Në mesin e gazetarëve, që u paditën për manipulime mediatike në funksion të nxitjes së krimeve në Kosovë, Shoqata e Gazetarëve të Pavarur të Serbisë akuzoi edhe Milovan Dracunin, gazetarin e çështjeve ushtarake e politike të Radio-Televizionit të Serbisë. Ky fakt është tepër domethënës, sepse padia është bërë nga Shoqata e Gazetarëve të Pavarur të Serbisë! Me qëllim që lexuesi ta ketë të qartë se për çfarë “gazetari” bëhet fjalë, po përmend edhe një fakt tjetër. Për meritat në nxitjen e kryerjes së gjenocidit kundër shqiptarëve gjatë luftës në Kosovë, Milovan Drecuni dhe kameramani i Radio-Televizionit të Serbisë, Tomislav Magoči, më 27 prill 1999 u dekoruan nga gjeneralkoloneli Nebojša Pavković (Nebojsa Pavković). Milovan Drecun-i dhe Tomislav Magoči ishin të vetmit gazetarë që u dekoruan nga komandanti i Armatës së Tretë Jugosllave, që udhëhoqi zbatimin e planit

gjenocidal kundër shqiptarëve në Kosovë. Për lexuesin që nuk e di se kush është Nebojša Pavković, do të përmend vetëm faktin se ai kërkohet nga Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë për katër vepra penale të kryera gjatë luftës në Kosovë: deportime, shpërngulje të dhunshme, vrasje dhe përndjekje. Më 25 prill 2005 ai u dorëzua tek autoritetet ndërkombëtare për t’u ballafaquar me drejtësinë. Në shkurt të vitit 2009 u dënua me 22 vjet burg. Akuza e Shoqatës së Gazetarëve të Pavarur të Serbisë për manipulime mediatike në funksion të nxitjes së krimeve, për përhapjen e urrejtjes ndërnacionale dhe ndërfetare, si dhe për nxitjen e diskriminimit dhe të armiqësive nuk pati asnjë pasojë për Milovan Drecunin. Përkundrazi, në zgjedhjet e 2012-s u bë deputet i Kuvendit Popullor të Republikës së Serbisë dhe u emërua kryetar i “Komisionit Parlamentar të Serbisë për Kosovë”! Pikërisht ky “gazetar” i Radio-Televizionit të Serbisë, i dekoruar nga komandanti i Armatës së Tretë të Jugosllavisë, që kreu krimet në Kosovë, gjeneralkoloneli Nebojša Pavković, u vu në krye të Grupit Punues serb, që përgatiti provat për Zyrën e Prokurorit të Specializuar në Hagë. Një muaj përpara se të bëhej konfirmimi i aktakuzës dhe të arrestoheshin Jakup Krasniqi, Hashim Thaçi, Kadri Veseli dhe Rexhep Selimi, Milovan Drecuni ishte i ftuar në

emisionin e titulluar “Fillon udhëtimi njëdrejtimësh nga Prishtina për në Hagë”, në TV Happy”. Gjatë bashkëbisedimit me gazetarët e “TV Happy”-t, Milovan Drecuni, në emër të Grupit Punues të Serbisë, flet me mospërfillje për ekipin e prokurorëve që punonin me kryeprokurorin David Swendiman, të cilët nuk i njihnin rrethanat ku kishin ndodhur ngjarjet, nuk dinin në çfarë drejtimi t’i zhvillonin hetimet. Në këtë kontekst Milovan Drecun pohon publikisht se Grupi Punues i Serbisë ka kontribuar shumë, që t’u japin drejtimin e duhur dhe t’u tregoj prokurorëve në çfarë drejtimi t’i zhvillojnë hetimet. Ai tregon se i ka orientuar drejt çështjes së qendrave ilegale të ndalimit, sepse “ka qenë më e lehtë për ta që të dëshmojnë krimet nëpërmjet këtyre qendrave ilegale. Ne u kemi dhënë: - listën e plotë të 159 qendrave të ndalimit që kanë identifikuar shërbimet tona, prej të cilave 6 ishin në veri të Shqipërisë; - emrat e atyre që i kanë krijuar këto qendra; - personat që i kanë keqtrajtuar njerëzit, që i kanë vlarë, që i kanë masakruar, dhunuar (kemi shumë raste të grave të përdhunara)...” Dhe për punën që ka bërë, Milovan Drecuni deklaron: “Qysh në fazën e parë unë kam marrë mirënjohje nga kryeprokurori Swendiman. Madje mirënjohja është shkruar me dorë, që është e pazakonshme, sepse po shihej që i kemi ndihmuar shumë të

shohin se në çfarë drejtimi duhet t’i zhvillojnë hetimet”. Paramendoni se në çfarë situatë paradoksale kemi ardhur: krimineli Milovan Drecun, që ka qenë i përfshirë drejtpërdrejt në nxitjen e krimeve ndaj shqiptarëve në Kosovë dhe ndaj të cilit Shoqata e Gazetarëve të Pavarur të Serbisë kishte dorëzuar padi, i ka përcaktuar Zyrës së Prokurorit Special të Kosovës se në çfarë drejtimi duhet t’i zhvillojë hetimet! Prandaj propozimi i Zyrës së Prokurorit të Specializuar për dënim me kohëzgjatje nga 45 vjetë burgim për Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Rexhep Selimin dhe Jakup Krasniqin është propozim logjik në përputhje me drejtimin që ua ka përcaktuar Shërbimi Sekret i Serbisë që përfaqësuesit e luftës çlirimtare të Kosovës të mos kthehen kurrë në Prishtinë, e që sintetizohet në thënien e Miroslav Drecunit “Fillon udhëtimi njëdrejtimësh nga Prishtina për në Hagë”. Ky propozim konfirmoi shqetësimet që para disa muajsh shprehu publikisht diplomati amerikan James Rubin për njëanshmërinë dhe qasjen paragjyquese të disa gjyqtarëve në procesin gjyqësor ku ai ishte dëshmitarë i mbrojtjes së Hashim Thaçit. Përball rrezikut që në vend të drejtësisë të vendosë politika, ftoj të gjithë shqiptarët që kanë mundësi të vijnë në Prishtinë dhe bashkërisht të marshojmë në Sheshin Skënderbeu” në Prishtinë në mbështetje të atyre që padrejtësisht mbahen prapa grilave.

SHBA-ja DO TË VAZHDOJË TA MBËSHTESË FSK-në ME PAJISJE USHTARAKE

PRISHTINË, 10 SHKURT - Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Kosovë do të vazhdojë ta mbështesë Forcën e Sigurisë së Kosovës në përvetësimin e pajisjeve ushtarake amerikane, duke promovuar kështu bizneset amerikane dhe lidhjet tregtare midis ShBA-së dhe Kosovës, tha një zëdhënës i ambasadës në Prishtinë për Radion Evropa e Lirë. Sipas tij, bashkëpunimi i fuqishëm ushtarak midis Shteteve të Bashkuara dhe Kosovës po e ndihmon FSK-në të arrijë vetëmjaftueshmëri dhe ta bëjë Kosovën një kontribuuese kyç për stabilitetin rajonal dhe global. “Shtetet e Bashkuara mbështesin plotësisht tranzicionin 10-vjeçar të Forcës së Sigurisë së Kosovës

në një forcë mbrojtëse territoriale shumëtnike, profesionale dhe të ndërveprueshme me NATO-n, e aftë për ta rritur sigurinë rajonale dhe për t’i promovuar interesat e sigurisë së ShBA-së”, tha zëdhënësi. Ai i bëri komentet në përgjigje të pyetjeve të Radios Evropa e Lirë se si e vlerësojnë Shtetet e Bashkuara fazën aktuale të transformimit të FSK-së në një forcë ushtarake dhe për rolin që ShBA-ja parashikon të luajë në fazën përfundimtare të këtij transformimi. FSK-ja e nisi këtë proces dhjetëvjeçar në vitin 2018, pas miratimit të ligjeve përkatëse nga Kuvendi i Kosovës, të cilat i hapën rrugë transformimit të saj në ushtri me kapacitete të plota.



Që atëherë, Shtetet e Bashkuara e kanë mbështetur këtë hap, duke e cilësuar tranzicionin si “historik” dhe duke konfirmuar angazhimin për zhvillimin profesional të forcës - ndryshe nga NATO-ja,

e cila e ka konsideruar vendimin “të papërshtatshëm në kohë”, për shkak të marrëdhënieve të tensionuara në mes të Kosovës dhe Serbisë. Zyrtarë të Ministrisë së Mbrojtjes në Kosovë kanë

konfirmuar për REL-in se transformimi pritet të përfundojë në vitin 2028, sipas planit. Tash për tash po zhvillohen kapacitetet ajrore, po forcohen regjimentet luftarake dhe po punohet për ta plotësuar komponentin e rezervës me 3 000 pjesëtarë, pasi objektivi për 5 000 trupa të rregullta është arritur tashmë. Vitet e fundit Kosova ka marrë ose blerë pajisje të ndryshme ushtarake nga ShBA-ja, përfshirë dronët RQ-20 Puma, raketat Javelin dhe automjetet Humvee. Aktualisht FSK-ja po përgatitet të bashkohet me Forcën Ndërkombëtare Stabilizuese për Gazën, e cila është pjesë e planit për paqe në këtë rajon, të propozuar nga presidenti amerikan Donald Trump.

KDI-ja: KOSOVA STAGNON NË LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT SIPAS CPI-s, KRIZA POLITIKE BLOKUI REFORMAT KUNDËR KORRUPSIONIT

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 10 SHKURT - Transparency International ka publikuar të martën Indeks e Perceptimit të Korrupsionit (CPI) për vitin 2025 i cili mat perceptimin e korrupsionit në 182 shtete të botës, duke u bazuar në të dhëna nga burime të pavarura ndërkombëtare, përfshirë Bankën Botërore, World Economic Forum dhe organizata të tjera globale kredibile.

Kosova këtë vit ka shënuar 43 pikë dhe është renditur në vendin 76 në mesin e 182 shteteve. Me një rënie prej një pike krahasuar me vitin e kaluar, si dhe me renditje prej tri pozitash më poshtë, Kosova ka ndërprerë trendin gradual të rritjes të cilin e kishte shënuar për rreth një dekadë.

Rënia në Indeks paraqet stagnim në luftën kundër korrupsionit dhe lidhet drejtpërdrejt me krizën parlamentare pas zgjedhjeve të 9 shkurtit 2025, e cila bllokoi funksionimin normal të institucioneve, rrjedhimisht zbatimin e reformave të rëndësishme në fushën anti-korrupsion.

Për herë të parë qeveria në një mandat të plotë nuk arriti ta miratojë strategjinë kombëtare kundër korrupsionit. Për më keq, viti 2025 u përmbyll pa u dekretuar Kryeprokurori i Shtetit, për shkak të kundërshtimeve të vazhdueshme nga presidentja, kryeministri dhe bartës të tjerë institucionalë.

Mosplotësimi i kësaj pozite kyçe për një periudhë të gjatë dobësoi funksionimin e sistemit prokurorial dhe krijoi pasiguri institucionale në raport me luftën kundër korrupsionit. Gjithashtu, vlen të theksohet që korrupsioni nuk ishte ndër temat qendrore të programeve zgjedhore në dy palë zgjedhjet e vitit të kaluar, ndryshe nga ciklet e mëparshme zgjedhore.

Viti 2025 u karakterizua nga hetime dhe aktakuza ndaj disa



zyrtarëve të lartë qeveritarë. Në rastin e njohur si “rezervat shtetërore” u ngrit aktakuzë ndaj ministres së Tregtisë dhe Industrisë për dëmtim të buxhetit rreth 3 milionë euro. Kryeministri në detyrë u thirr si dëshmitar në këtë rast, por refuzoi disa herë të paraqitet para Prokurorisë Speciale. Refuzimi i bashkëpunimit me organet e ndjekjes penale nga nivelet më të larta ekzekutive minon besimin në pavarësinë e drejtësisë dhe dëmton rëndë kulturën e llogaridhënies publike, duke ndikuar drejtpërdrejt në perceptimin e korrupsionit.

Megjithatë, përkundër hetimeve dhe aktakuzave, në Kosovë ende nuk ka pasur asnjë aktgjykim përfundimtar për dënim me burgim efektiv të zyrtarëve të lartë publikë për vepra korruptive - çka krijon perceptim të pandëshkueshmërisë, duke ulur besimin publik në drejtësi dhe në efektivitetin e luftës kundër korrupsionit.

Reformat në sistemin e drejtësisë gjatë vitit 2025 u paralizuan. Mungesa e Kuvendit funksional pengoi miratimin e projektligjeve të pakos së reformës dhe amendamenteve kushtetuese

për procesin e vettingut.

Disa ligje kyçe, përfshirë atë për Byronë për Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme, vijuan të presin verdiktin e Gjykatës Kushtetuese deri në janar të këtij viti. Edhe pse Ligji i ri për Këshillin Prokurorial të Kosovës hyri në fuqi dhe nga janari 2026 pritej të prodhoheshin efektet e para të reformës, zhvillimet e fundit në KPK shpërfaqin pengesa të brendshme dhe rezistencë të hapur ndaj rikalibrimit institucional nga një pjesë e strukturave të vjetra të sistemit prokurorial.

Gjatë fundit të vitit të kaluar një grup anëtarësh të vjetër të KPK-së morën vendime të kundërligjshme, duke shkarkuar ushtruesin e detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit dhe duke bllokuar emërimin e një anëtar të ri, në përpjekje për ta penguar rikonfigurimin e kuorumit që do ta lejonte zbatimin e reformës.

Qeveria në detyrë ka vazhduar të marrë vendime me pasoja buxhetore në mungesë të transparencës dhe kontrollit parlamentar, ndërsa në disa raste janë evidentuar përdorime të fondeve publike për qëllime elektorale.

Në të njëjtën kohë janë

evidentuar raste sistematike kur eksponentë të partisë në pushtet kanë ushtruar presion ndaj medieve, organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve të drejtësisë përmes diskursit delegitimues dhe sulmeve publike. Këto veprime nuk janë vetëm retorikë politike, por përpjekje për ta dobësuar mbikëqyrjen kritike. Ngushtimi i hapësirës qytetare është tregues i drejtpërdrejtë i dobësimit të kontrollit demokratik mbi pushtetin.

Në anën tjetër, një pjesë e konsiderueshme e pozitave të larta vendimmarrëse gjatë kësaj periudhe u mbajtën me ushtrues detyre, çka dobëson përgjegjësinë institucionale dhe pengon stabilitetin e vendimmarrjes.

Edhe në fushat e tjera që lidhen me integritetin publik, përkatësisht prokurimin dhe shpenzimin e parasë publike, pati stagnime.

Korniza ligjore për konfliktin e interesit mbetet e paplotë, veçanërisht në raport me lobimin në procesin legjislativ, fenomenin e “dyerve rrotulluese” dhe pronësinë përfituese. Publikimi i të dhënave në formatet e hapura dhe të përpunueshme dhe

interoperabiliteti i tyre mbetet shumë i kufizuar.

Përfundimisht, KDI-ja vlerëson se stagnimi i këtij viti është pasojë e drejtpërdrejtë e krizës politike dhe mungesës së funksionimit të plotë institucional.

Pa Kuvend funksional, pa reforma të zbatuara dhe pa ndëshkueshmëri reale, progresi kundër korrupsionit mbetet i brishtë. Për këtë arsye, formimi i menjëhershëm i institucioneve të reja pas zgjedhjeve të 28 dhjetorit është kusht thelbësor për rikthimin e funksionimit normal të shtetit dhe rifillimin e reformave të bllokuara.

Prandaj, KDI-ja kërkon që Kuvendi dhe Qeveria e re të veprojnë pa periudhë tranzicioni të zgjatur, duke vendosur në krye të agjendës luftën kundër korrupsionit, përfshirë miratimin e strategjisë kombëtare kundër korrupsionit, finalizimin e paketës së reformës në drejtësi, zbatimin e plotë të reformës në Këshillin Prokurorial dhe sigurimin e ndëshkueshmërisë efektive për korrupsionin e nivelit të lartë. Po aq urgjente është rivendosja e kontrollit parlamentar mbi vendimmarrjen buxhetore, forcimi i transparencës në prokurimin publik dhe mbrojtja e hapësirës qytetare nga presioni politik. Pa këta hapa konkretë dhe të menjëhershëm, çdo premtim për luftë kundër korrupsionit rrezikon të mbetet deklarativ dhe të shndërrohet në regres afatgjatë për sundimin e ligjit në Kosovë.

Në krahasim me rajonin e Ballkanit Perëndimor, renditja sipas pikëve është si vijon: Mali i Zi (46), Kosova (43), Maqedonia e Veriut (40), Shqipëria (39), Bosnjë e Hercegovina (34) dhe Serbia (33). Kosova mbetet e dyta në rajon, por rënia e këtij viti ndërpret trendin e rritjes së viteve të fundit dhe e vendos vendin në një fazë stagnimi në një kohë kur rajoni në tërësi përballet me dobësim të institucioneve dhe reduktim reformash.

Specialja liron Haxhi Shalën, Bashkim Smakajn dhe Fadil Fazliun

PRISHTINË, 10 SHKURT - Kryetarja e Dhomave të Specializuara të Kosovës (DHKS), gjykatëse Ekaterina Trendafilova, ka vendosur ta modifikojë dënimin e Haxhi Shalës për ta mundësuar lirimin e tij me kushtet e përcaktuara në vendimin e saj. “Këto kushte do të vazhdojnë të zbatohen për pjesën e mbetur nga 3 vitet e dënimit të tij. z. Shala u lirua dhe u kthye në Kosovë më 10

shkurt”, kanë njoftuar Dhomat e Specializuara në Hagë, derisa kanë njoftuar edhe për lirimin me kusht edhe për Bashkim Smakajn dhe Fadil Fazliun. “Në vendimet e tij të 3 shkurtit 2026, Gjykatësi konstatoi se rrethanat kishin ndryshuar që prej rishikimit të paraburgimit të z. Smakaj dhe z. Fazliu në dhjetor 2025 dhe se mbajtja e tyre në paraburgim nuk ishte më e arsyeshme apo

proporcionale. Megjithëse Gjykatësi konstatoi se ende ekzistonte njëfarë rreziku që, në qoftë se lirohen, si z. Smakaj ashtu edhe z. Fazliu mund të pengojnë ecurinë e procesit, ai arriti në përfundimin se e drejta themelore e tyre për liri peshon më shumë se këto rreziqe”, kanë njoftuar Dhomat e Specializuara në Hagë.



Sindikata e Punëtorëve Privatë: Shumë kompani nuk po e respektojnë rritjen e pagës minimale prej 425 eurosh

PRISHTINË, 10 SHKURT - Federata Sindikale e Punëtorëve Teknikë e Sektorit Privat të Kosovës (FSPTSPK) ka njoftuar se edhe pse paga minimale prej 425 eurosh bruto, e cila hyri në fuqi më 1 janar 2026 sipas vendimit të Qeverisë së Kosovës, në shumë raste nuk po respektohet. Sipas FSPTSPK-së, shumica e punëtorëve

teknikë në institucione publike përmes kompanive private kanë marrë rritje pagash, por në disa raste ka kompani që ende nuk kanë kryer pagesën për muajin janar dhe për këto raste ende nuk kemi informata të plota se sa po zbatohet ky vendim. “Ekzistojnë raste konkrete, si në Shkollën e Mesme Teknike dhe Gjimnazi

në Drenas, ku punëtorët teknik vazhdojnë të marrin pagë prej 237 euro neto, pa asnjë ndryshim apo zbatim të vendimit për rritjen e pagës minimale”, thuhet në njoftim. Gjithashtu, sipas FSPTSPK-së, në disa shkolla të Prishtinës punëtorët teknikë ende nuk kanë marrë pagat dhe nuk do të ketë rritje të pagës.

Ndërkaq, punëtorët teknikë në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Prishtinë marrin pagë 370 euro, që është nën pagën minimale të parashikuar. Federata bën thirrje të fortë për kompanitë që nuk po e respektojnë vendimin. “Kërkojmë nga të gjitha kompanitë që nuk po e respektojnë vendimin për



pagën minimale, të ndërmarrin masa të menjëhershme dhe ta zbatojnë atë sa më shpejt, në përputhje me legjislacionin në fuqi”, thuhet në njoftim.

ISMAILI MIRËPRET MISIONIN E ASISTENCËS TEKNIKE TË FMN-së PËR FORCIMIN E MODELIMIT DHE PARASHIKIMIT MAKROEKONOMIK



PRISHTINË, 10 SHKURT - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Ahmet Ismaili, së bashku me ekipin e tij, mirëpriti ekipin e misionit të asistencës teknike të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), të udhëhequr nga Yunhui Zhao nga selia qendrore e FMN-së. Misioni përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt forcimit të mëtejshëm të kapaciteteve të BQK-së në parashikimin makroekonomik dhe analizën e politikave në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare.

Projekti i asistencës teknike pason diskutimet e mëhershme të zhvilluara gjatë Takimeve Vjetore në Uashington DC ndërmjet guvernatorit Ismaili dhe Institutit për Zhvillimin e Kapaciteteve (ICD) të FMN-së (përfshirë menaxhmentin e lartë të ICD-së), si dhe kërkesën formale të BQK-së për këtë mbështetje dhe misionin hyrës të realizuar në shtator 2025. Gjatë takimit, guvernatori Ismaili e njoftoi ekipin e FMN-së mbi zhvillimet e fundit në sektorin financiar të Kosovës dhe për reformat e ndërmarra nga BQK-

ja me qëllim forcimin e stabilitetit financiar dhe rritjen e efektivitetit të politikave. Ai, po ashtu, paraqiti pritshmëritë e institucionit nga ky angazhim, duke theksuar rëndësinë e tij për forcimin e kapaciteteve analitike dhe mbështetjen e vendimmarrjes së bazuar në evidencë. Guvernatori Ismaili theksoi se asistencë teknike do të kontribuojë në ndërtimin e kapaciteteve të qëndrueshme të brendshme dhe në rritjen e mëtejme të cilësisë së kornizës së politikave makroekonomike, në

përputhje me Planin Strategjik të BQK-së. Korniza analitike që do të zhvillohet do t'i forcojë kapacitetet analitike dhe parashikuese të BQK-së, përfshirë zhvillimin e skenarëve për diskutime të politikave dhe testimet e stresit makro-financiar, duke mbështetur kështu procesin e politikëbërjes së BQK-së. Zhao prezantoi objektivat e dakorduara të projektit shumëvjeçar të asistencës teknike, i cili synon kryesisht krijimin e një infrastrukture të qëndrueshme analitike për të

mundësuar parashikime të besueshme dhe analiza skenarësh që informojnë procesin e vendimmarrjes. Në përfundim, BQK-ja dhe ekipi i FMN-së rikonfirmuan angazhimin e tyre për bashkëpunim të vazhdueshëm dhe për sigurimin e zbatimit të suksesshëm të këtij projekti të rëndësishëm. BQK-ja vlerëson lart mbështetjen e FMN-së dhe njeh vlerën e konsiderueshme të projekteve të asistencës teknike në forcimin e kapaciteteve institucionale.

ZKA-ja auditon Sistemin Informativ për skemat pensionale në Kosovë

PRISHTINË, 10 SHKURT - Në kuadër të zbatimit të Planit Vjetor të Auditimit, Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka filluar auditimin e teknologjisë së informacionit “Sistemi i Integruar Informativ (SII) për skemat pensionale në Kosovë”, për periudhën 2024-2026. Fushëveprimi i këtij auditimi është Ministria e Financave,

Punës dhe Transfereve, përkatësisht Departamenti i Pensioneve, në kuadër të të cilit përfshihen edhe zyrat regionale. Gjithashtu, në fushëveprim është paraparë edhe Agjencia Kosovare e Privatizimit për rolin e saj në ruajtjen dhe inventarizimin e dosjeve të punëtorëve në ndërmarrjet shoqërore të Kosovës si dhe

Arkivi Shtetëror i Kosovës për rolin e tij në procesin e dokumenteve të arkivuara. Auditimi ka për qëllim të vlerësojë nëse Sistemi i Integruar Informativ për skemat pensionale funksionon në mënyrë efektive duke siguruar të dhëna të sakta, me shërbime të digjitalizuara si dhe në kohë reale për qytetarët.



MISTERI EPSTEIN THELLOHET: DOKUMENTET HEDHIN DYSHIME MBI ORËN REALE TË VDEKJES

Me një ritëm marramendës, çdo ditë dalin në dritë të dhëna të reja që lidhen si me jetën e trazuar të Jeffrey Epstein, ashtu edhe me personat me të cilët ai kishte qoftë edhe kontaktin më minimal, por edhe me momentet e tij të fundit në burg.

Një dokument i ri, i zbuluar mes më shumë se 3.5 milionë dosjeve të publikuara nga Departamenti Amerikan i Drejtësisë, dhe konkretisht një njoftim zyrtar federal, konfirmon vdekjen e financierit.


Megjithatë, dokumenti mban një datë që duket se i paraprin momentit kur zyrtarisht u konstatua se ai ishte gjetur i vdekur në qelinë e tij, në një burg të Nju Jorkut.

Dokumenti, i lëshuar nga Zyra e Prokurorit Federal për Distriktin Jugor të Nju Jorkut dhe i datuar të premten, më 9 gusht 2019, pohon se Jeffrey Epstein ishte gjetur tashmë pa ndjenja dhe se ishte konstatuar vdekja e tij.

Sidoqoftë, të dhënat e burgut dhe njoftimet zyrtare tregojnë se financieri nuk u gjet pa ndjenja deri në mëngjesin e 10 gushtit 2019, kur një punonjësi i shërbimit korrektues, gjatë shpërndarjes së mëngjesit, e gjeti atë në qelinë e tij në Qendrën Federale të Paraburgimit në Manhatan.

Në deklaratën e prokurorisë që doli së fundmi në dritë, prokurori federal i atëhershëm i Manhatanit, Xhefri S. Berman, deklaronte: "Herët këtë mëngjes, Qendra Federale e Paraburgimit në Manhatan konfirmoi se Jeffrey Epstein, i cili përballëj me akuza të ngritura nga zyra jonë për përfshirje në trafikim seksual të të miturve, u gjet pa ndjenja në qelinë e tij dhe pak më vonë u konstatua vdekja e tij.

Ngjarjet e sotme janë shqetësuese dhe jemi plotësisht të vetëdijshëm se mund të përbëjnë një tjetër pengesë për t'u dhënë viktimave të shumta të Jeffrey Epstein mundësinë të flasin në gjykatë. Vajzave të reja dhe të



guximshme që kanë folur tashmë, si dhe shumë të tjerave që ende nuk e kanë bërë këtë, dua t'u përsëris se mbetemi të përkushtuar të qëndrojmë në krahun tuaj dhe të vazhdojmë hetimin për veprimet e përshkruara në aktakuzë."

Jeffrey Epstein, 66 vjeç, mbahej në burgun e Manhatanit që nga arrestimi i tij më 6 korrik 2019, pasi prokurorët federalë i kishin ngritur akuza për trafikim seksual të të miturve dhe komplot.

Ai kshite deklaruar se ishte i pafajshëm dhe priste të dilte në gjyq, kur rreth një muaj pas arrestimit vendosi t'i jepte fund jetës së tij. Sipas njoftimeve zyrtare, Epstein u gjet pa ndjenja në qelinë e tij pak pas orës 06:30 të mëngjesit të 10 gushtit nga një punonjësi korrektues. Personeli mjekësor tentoi ta reanimonte, por pak më vonë u konstatua vdekja e tij. Më pas, mjeku ligjor i Nju Jorkut vendosi se shkaku i vdekjes ishte vetëvrasja me varje.

Vdekja e financierit ndodhi mes një sërë dështimesh serioze në një nga institucionet më të sigurta të paraburgimit të qeverisë federale. Të dhënat e burgut tregojnë se rojet përgjegjëse për mbikëqyrjen e tij nuk kryen kontrollat e parashikuara gjatë orëve të natës përpara se të gjendej trupi i tij.

Sipas përfundimeve zyrtare, patrullimet e planifikuara në orën 03:00 dhe 05:00 të mëngjesit nuk u realizuan. Për më tepër, kamerat e sigurisë të vendosura jashtë qelisë së Epsteinit nuk funksiononin siç duhet atë natë. Hetuesit konfirmuan më vonë se të paktën dy kamera vëzhgimi kishin pësuar defekte, duke lënë boshllëqe kritike në monitorimin vizual të zonës.

Për shkak të këtyre mangësive, autoritetet nuk arritën të përcaktonin me saktësi një kronologji të plotë të momenteve të fundit të financierit. Deri më sot, ora e saktë e vdekjes nuk



është përcaktuar zyrtarisht.

Më herët gjatë kësaj jave, dosjet e publikuara së fundmi nga Departamenti i Drejtësisë përfshinin detaje shtesë që hetuesit kishin analizuar pas vdekjes së Epsteinit, përfshirë edhe vëzhgime nga sistemi i brendshëm i sigurisë së burgut.

Sipas dokumenteve, hetues të FBI-së dhe të Zyrës së Inspektorit të Përgjithshëm të Departamentit të Drejtësisë zbuluan pamje që duket se tregonin një figurë të paidentifikuar duke lëvizur drejt katit ku mbahej Epstein.

Pamjet dyshohet se kanë regjistruar një figurë me ngjyrë portokalli duke u ngritur në një shkallë pranë njësisë së paraburgimit të Epsteinit gjatë natës. Hetuesit e dokumentuan këtë lëvizje, por nuk arritën të konkludonin publikisht nëse kjo figurë kishte ndonjë lidhje të drejtpërdrejtë me Epsteinin apo me vdekjen e tij.

Kufizimet dhe keqfunksionimet e


sistemit të mbikëqyrjes nuk i lejuan hetuesit të rindërtonin plotësisht regjistrimin vizual të aktivitetit në këtë sektor të burgut.

Vdekja e Epstein i dha fund papritur një prej çështjeve penale federale më të përfolura të viteve të fundit.

Prokurorët e akuzonin atë se për vite me radhë kishte organizuar një rrjet trafikimi seksual të vajzave të mitura, me viktimat të dyshuara që përshkruanin abuzime të shtrira në disa shtete dhe vende të ndryshme.

Arrestimi i tij në korrik të vitit 2019 pasoi vite hetimesh dhe kritikash lidhur me marrëveshjen që kishte arritur në Florida në vitin 2008, e cila i kishte mundësuar t'i shpëtonte ndjekjes penale federale në atë kohë.

Akuzat e reja të ngritura ndaj tij në Nju Jork e ekspozonin ndaj rrezikut të një dënimi me shumë vite burg, në rast se do të shpallej fajtor.





SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com





QENDRA SPORTIVE

'BUJOËSIA'

TEL: 045/82 82 82

Ismet Munishi zyrtarizohet te Liria

PRIZREN, 10 SHKURT - Ismet Munishi edhe zyrtarisht është konfirmuar si trajner i ri i Lirisë. Pasi kanë shkarkuar trajnerin Liridon Leci, drejtuesit e skuadrës nga Prizreni kanë arritur marrëveshje me trajnerin e mirënjohur, që ishte

i papunë që kur ishte larguar nga Dukagjini i Klinës. Vetëm dy rreshta i kanë mjaftuar klubit prizrenas për ta paraqitur njërin nga trajnerët më karizmatik. “Mirë se vjen, Ismet Munishi! FC Liria mirëpret trajnerin e ri të ekipit të parë.

Munishi është një nga emrat më të njohur të futbollit të Kosovës”, ka njoftuar FC Liria. Munishi, i cili kthehet në Ligën e Parë për të udhëhequr një ekip, pas Ferizajt dy vjet më parë, ai do të ketë detyrë të vështirë për ta kthyer klubin në

Superligë. Aktualisht Liria është në vendin e gjashtë në tabelë me 36 pikë, pesë më pak se liderja e ligës, Vushtrria. Testi i parë i Munishit me Lirinë do të jetë përballja në kuadër të Kupës, të enjten, në udhëtim te Gjilani.



MBAHET PUNËTORIA PËR PROCESIN E LICENCIMIT TË KLUBEVE PËR GARAT EVROPIANE PËR EDICIONIN 2026-2027

PRISHTINË, 10 SHKURT - Në Federatën e Futbollit të Kosovës (FFK) është mbajtur punëtorja e radhës në kuadër të Departamentit të Licencimit, me pjesëmarrjen e klubeve të Superligës dhe Ligës së Parë, ku janë diskutuar çështje të rëndësishme të procesit të licencimit të klubeve për garat e UEFA-s për edicionin 2026-2027. Punëtorinë e ka hapur presidenti i FFK-së, Agim Ademi, i cili ka theksuar rëndësinë e licencimit të klubeve si një proces thelbësor për zhvillimin dhe profesionalizimin e futbollit në vendin tonë. Më pas, menaxheri i Departamentit të Licencimit, Bajram Shala, ka njoftuar

pjesëmarrësit për kompletimin e strukturës së këtij departamenti. Erika Krasniqi është emëruar zëvendës-menaxhere e Licencimit, ndërsa si ekspertë të kriterëve janë emëruar Agron Shosholli për Kriterin e Personelit dhe Administratës, Besim Ademi, për Kriterin Sportiv, Haris Abdixhiku për Kriterin Infrastrukturor dhe Fis Murati për Kriterin Ligjor. Po ashtu, juristi Bashkim Preteni është bërë pjesë e Komisionit të Shkallës së Parë, ndërsa në Komisionin e Shkallës së Dytë është angazhuar juristi Labinot Murati.



Gjatë prezantimit të tij Shala ka potencuar disa nga pikat më të rëndësishme të procesit të licencimit, përfshirë kriteret specifike dhe afatet për dorëzimin e dokumentacionit nga klubet. Në vazhdim Dardan Sadiku, përgjegjës për Departamentin e Teknologjisë Informativë, ka paraqitur implementimin e platformës MyFFK (Football Management System), e cila nga

ky sezon do të përdoret edhe në Departamentin e Licencimit. Fillimisht, sistemi do të funksionojë si projekt pilot, ku klubet do të kenë mundësi të përdorin paralelisht MyFFK-në dhe mënyrat tradicionale të dorëzimit të dokumenteve. Megjithatë, MyFFK do të jetë platforma kryesore për komunikim dhe dorëzim të dokumentacionit për të gjitha klubet. Në anën tjetër, Doruntinë Fetahaj, përgjegjëse e Qëndrueshmërisë Sociale dhe Mjedisore në FFK, ka folur për rëndësinë e qëndrueshmërisë mjedisore, e cila tashmë ka marrë peshë më të

madhe edhe në kuadër të UEFA-s dhe është bërë pjesë e rëndësishme e procesit të licencimit. Ajo ka theksuar nevojën që klubet të vetëdijesohen për krijimin e ambienteve më të sigurta dhe më të qëndrueshme për zhvillimin e aktiviteteve të futbollit, duke përfshirë riciklimin e plastikës dhe materialeve të tjera që përdoren gjatë organizimit të ndeshjeve. Gjatë kësaj punëtorie është ritheksuar se FFK-ja mbetet e përkushtuar në avancimin e vazhdueshëm të procesit të licencimit në përputhje me rregulloret e UEFA-s dhe standardet bashkëkohore të futbollit.

FIFA ACADEMY HAP DYERT NË KOSOVË

PRISHTINË, 10 SHKURT - FIFA Academy ka hapur dyert për herë të parë në Kosovë. Ky është një program zyrtar zhvillimi i krijuar nga FIFA, me qëllim identifikimin, edukimin dhe zhvillimin e talenteve të reja në futboll, sipas standardeve më të larta ndërkombëtare. Ky program, po ashtu, synon të ndërtojë një bazë të qëndrueshme për futbollin e së ardhmes, duke u

fokusuar në cilësinë e trajnimit, edukimin sportiv dhe zhvillimin afatgjatë të lojtarëve të rinj. “Me krenari njoftojmë se FIFA Academy është për herë të parë e pranishme në rajon, në Kosovë, nëpërmjet programit Talent Coach Program, duke shënuar një hap shumë të rëndësishëm për zhvillimin e futbollit vendor dhe rajonal. Prania e FIFA Academy në Kosovë sjell metoda moderne

trajnimi, planprograme të certifikuar nga FIFA dhe një qasje profesionale, e cila përputhet me praktikën më të mira botërore”, ka njoftuar e FFK-së. Kjo iniciativë përfaqëson një mundësi unike për fëmijët dhe të rinjtë që të zhvillohen në një ambient profesional, të sigurt dhe edukativ, duke ndërtuar jo vetëm aftësi futbolistike, por edhe vlera sportive dhe njerëzore. “Nga data

7 shkurt 2026, ky projekt ka nisur me fazën e parë të implementimit, konkretisht me seleksionimin e lojtarëve të moshës 12-13 në të gjitha regionet e Kosovës. Pas qytetit të Ferizajt, sot ky program është zhvendosur në Gjilan, ndërsa aktivitetet seleksionuese do të zhvillohen edhe nesër, për të vazhduar më pas në qytetet e tjera”, ka njoftuar FFK-ja.



DORTMUNDI, FAVORIT PËR FISNIK ASLLANIN



HOFFENHEIM, 10 SHKURT - Sulmuesi i Kosovës, Fisnik Asllani, do të largohet në verë nga Hoffenheimi, por jo edhe nga Bundesliga e Gjermanisë. Asllani me të përfunduar sezoni aktual pritet të transferohet te Borussia Dortmundi, ekip favorit për

shërbimet e tij. Tërheqja e Bayernit nga gara për Asllanin duket se i ka dhënë avantazh Dortmundit për sulmuesin kosovar, i cili po pëlqen qëndrimin në kampionatin gjerman. 23-vjeçari ka kontratë me Hoffenheimin deri në vitin

2029 dhe një klauzolë liri në vlerë prej 30 milionë eurosh të cilën Dortmundi është gati ta paguajë. Në sezonin e tij të parë në Bundesligë, Asllani ka shënuar 6 gola dhe ka bërë po aq asistime në 20 ndeshje të luajtura deri më tani. Gjithashtu, Asllani ka tërhequr

edhe vëmendjen e ekipeve nga kampionatet e tjera, që mbeten në garë për transferimin e tij. Në mesin e skuadrave që e shohin Asllanin si opsion të mirë për sulmin janë Barcelona, Juventus, Tottenhami, Chelsea e Fenerbahçe.

Jose Mourinho pritet të bëhet trajner i Portugalisë

LISBONË, 10 SHKURT - Jose Mourinho është raportuar në mediet ndërkombëtare se do të jetë trajner i ri i Kombëtares së Portugalisë, duke pasuar Roberto Martinezin pas përfundimit të Kupës së Botës 2026. Sipas mediumit “ESPN”,

Portugalia është gati t'i drejtohet trajnerit të Benficas, Mourinho, për rolin e trajnerit kryesor. Kombëtarja portugeze e ka zgjedhur ish-trajnerin e Chelseat dhe Real Madridit si pasardhësin e Roberto Martinez, kontrata e të cilit

skadon pas Kupës së Botës 2026. E ardhmja e Mourinhos te Benfica ka qenë tashmë subjekt i spekulimeve të forta, me thashetheme që e lidhin atë me një largim. Klubi portugez do ta ndjekë Ruben

Amorimin nëse Mourinho pranon punën në ekipin kombëtar. Portugalia do të hyjë në Kupën e Botës 2026 si një nga favoritët e fortë nën drejtimin e Martinezit pasi ka bindur edhe në kualifikuese.



NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Via Egnatia Resources” SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810858110 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Via Egnatia Resources” D.O.O. Pristina donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810858110 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Via Egnatia Resources” L.L.C. with headquarters Pristina, has come to the decision to quit its business: 810858110 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Peshter Gold” SH.P.K. me seli në Obiliq, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812060995dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Peshter Gold” D.O.O. Obiliq donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812060995 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Peshter Gold” L.L.C. with headquarters Obiliq, has come to the decision to quit its business: 812060995 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Selim Xhafa shpall te pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të lartë teknike “Arkitekt Sinani”.

- Sadete Topalli shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Migjeni” Baice Drenas.

- Nerxhivane Shabani shpall te pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të lartë të Gjmnazit “Frang Bardhi”.

- Florian Gllareva shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Dëshmoret e Fortesës” Verboc Drenas.

- Enis Çoçaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Zenun Çoçaj”.

- Denis Çoçaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Zenun Çoçaj”.

- Andi Rezniqi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës se mesme ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë.

- Osman Gjigja shpall të pavlefshme dëftesën e plotë shfmu “Shaban Golaj” Lipovec Gjakovë.

- Arifqe Gutaj shpall të pavlefshme dëftesën e sh.m.u të gjmnazit “Gjon Buzuku” Prizren.

- Maurita Koca nga Bishtazhini KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjmnazit “Hajdar Duishi” Gjakovë.

- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjmnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, “Metal Teknika Asllani” Shpk, Fushë Kosovë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, për impiantin fotovoltaiik “Parku Solar MTA” me kapacitet 3 MWp në Vrellë të Goleshit, Komuna Lipjan.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 31.03.2026 ora 11:00 në objektin e Komunës së Lipjanit, do të organizohet debat publik nga “Metal Teknika Asllani” Shpk, Fushë Kosovë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

https://eu-central-1.protection.sophos.com?d=zoom.us&u=aHR0cHM6Ly91czA0d2ViLn timer 20udXMvai80NTQ5MzQ0NDk1P3B3ZD1HYktjb2NjU1d4MzI GM2U4UUUY3UHNBa0NNM2J2SzYuMQ==&i=NjY1ZjJjOWVlZmMxZjE3Nzc3ZW MxNzcy&t=Mnh5R0tSSG1OT1M1Wk9BdGtQZUI4S3E1eTO0MmsvNnZxZU5zSW5XSC9nMD0=&h=799d264eb0ad4d7fab2eca87921eae52&s=AVNPUEhUT0NFTkNSWVBUSVaTRAueU-vNbNdW92a0FAisFOgf0Rln55_29at16bUHiQ

Meeting ID: 454 934 4495
Passcode: Aela2019.

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për “Metal Teknika Asllani” Shpk, Fushë Kosovë, për impiantin fotovoltaiik “Parku Solar MTA” me kapacitet 3 MWp në Vrellë të Goleshit, Komuna Lipjan.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin

vn timer.komente@rks-gov.net

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, “Arberi EB” Shpk, Gjakovë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, për shfrytëzimin e rërës dhe zhavorit në Shishman, Komuna e Gjakovës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 30.03.2026 ora 14:00 në Shkollën “Sylejman Vokshi”, Smolicë, Komuna e Gjakovës, do të organizohet debat publik nga “Arberi EB” Shpk, Gjakovë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

<https://us04web.zoom.us/j/4549344495?pwd=GbKcoccSWx39F3e8QF7PsAkCM3bvK6.1>

Meeting ID: 454 934 4495
Passcode: Aela2019.

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për “Arberi EB” Shpk, Gjakovë, për Pëlqim Mjedisor, për shfrytëzimin e rërës dhe zhavorit në Shishman, Komuna e Gjakovës.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin

vn timer.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, “R50kt” Shpk, Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, për parkun e energjisë diellore në lokalitetin Ramjan, Komuna Viti.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 30.03.2026 në ora 10:00 në sallën e Kuvendit, Komuna e Vitisë, do të organizohet debat publik nga “R50kt” Shpk, Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

<https://us04web.zoom.us/j/4549344495?pwd=GbKcoccSWx39F3e8QF7PsAkCM3bvK6.1>

Meeting ID: 454 934 4495
Passcode: Aela2019.

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për “R50kt” Shpk, Prishtinë, për Pëlqim Mjedisor, për parkun e energjisë diellore në lokalitetin Ramjan, Komuna Viti.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin

vn timer.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992





ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L